



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.29/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 11.01.2011, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

ARSYETIMI

Më datën 09.01.2011, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se “me datë 09.01.2011 në fshatin Rakinicë komuna e Skenderajt në QV 2129b ka një dallim prej 20 votash ndërmjet fletëvotimeve që gjenden te anëtari i VV dhe numrit të votuesve të cilat kane votuar”. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale si dëshmi, që do të bënte të besueshme ekzistimin e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 29/2011 më datën 11.01.2011

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

